

VENDIM
Nr. 866, datë 23.10.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 638, DATË 22.7.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË, NË PROGRAMET
E STUDIMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE DHE NË PROGRAMET E
INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, SI
EDHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 24, 34, 35, 36 e 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 135, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7748, datë 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye ose për shkak të detyrës”, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe zëvendësohet me: “Për kuotat e pranimit dhe tarifën e studimit në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015 - 2016.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Kuotat e përgjithshme për pranimet e reja në programet e studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, janë 18239 kuota, nga të cilat 10360 kuota për programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe 7879 kuota për programet e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, të shpërndara sipas shtojcës 1/1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Përzgjedhja e studentëve për vitin akademik 2015- 2016 do të bëhet në bazë të kriterëve të vendosura nga vetë institucionet e arsimit të lartë.”.

3. Në fund të pikës 7 shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, do të jetë sipas tabelave 1/1 dhe 2/2 bashkëlidhur këtij vendimi. Studentët, që do të transferojnë studimet në programe të ngjashme studimi, do t’i nënshtrohen tarifës për kredit të programit të studimit përkatës, të parashikuar në këtë vendim.

Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, në kuadër të marrëveshjes ndërshtetërore, është parashikuar ndryshe.”.

4. Në fund të pikës 18 shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Kuotat e pranimit për shtetasit e huaj, për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit, për të verbrit, për romët dhe ballkano-egjiptianët, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuara në shtojcën 1/1 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shpërndahen bazuar në udhëzimin përkatës të ministrit të Arsimit dhe Sportit. Rishpërndarja e këtyre kuotave kryhet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Çdo program studimi i ciklit të dytë, me kohë të plotë, funksionon për vitin e parë, për vitin akademik 2015-2016, në rast se në këtë program studimi regjistrohen të paktën 10 studentë, përjashtuar Universitetin e Arteve, Tiranë. Për programet e studimit, për të cilat janë akorduar kuota për disa profile së bashku, institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të aplikimeve u komunikojnë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Provimeve programet e studimit me profilin përkatës, në të cilat ka të paktën 10 studentë të regjistruar dhe që do të fillojnë veprimtarinë akademike për vitin akademik 2015-2016.

Studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar programin përkatës të studimit apo nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohëzgjatjen normale të tij, dhe konsiderohen studentë mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë çdo vit akademik dyfishin e tarifës për kredit të parashikuar në këtë vendim.

Studentët, të cilët vijnë nga shtresat sociale, sipas përcaktimeve në shtojcën 1/2 bashkëlidhur këtij vendimi, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit në të gjitha programet e studimeve të ciklit të parë "Bachelor", programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

Studentët, të cilët vijnë nga shtresat sociale, sipas përcaktimeve në shtojcën 1/3 bashkëlidhur këtij vendimi, paguajnë 50% të tarifës vjetore të shkollimit, në rast se ndjekin ciklin e dytë të studimeve, me formë studimi me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama